

PROCES VERBAL VLERESIMI

Date 14.03.2017

Mr. 11/1

Komisioni i Dhënies se Koncesionit (Komisioni) për "ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë" është mbledhur sot, me date 14.03.2017, për të vlerësuar përmbushjen e kriterëve kualifikuese nga ana e ofertuesit si dhe për të vlerësuar Oferten e paraqitur, për ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.

Sikurse është konstatuar në proces verbalin e hapjes, në këtë procedurë konkurruese ka dorëzuar ofertën vetëm 1 (një) ofertues, dhe konkretisht:

1. Shoqëria "Integrated Energy B.V."

Ofertat përmbledhëse, referuar Shtojcës nr. 1 të DSK, të plotësuar dhe të nënshkruar, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Kriteret	Njësia e matjes	Shoqëria "Integrated Energy B.V."
1	Vlera e Investimit	Euro	128,248,330
2	Vlera e Fee Koncesionare	%	2.1
3	Koha e ndërtimit dhe venies në shfrytëzim	Muaj	6
4	Vlera e depozitimit të mbetjete	Euro/Ton	29

Fillimisht, është marrë në shqyrtim dokumentacioni kualifikues ligjor, ekonomik dhe teknik, ku janë konstatuar se janë dorëzuar dokumentacioni i mëposhtëm:

Relacion mbi përmbushjen e Kapacitetit Ligjor

Shoqëria "Integrated Energy B.V.", sh.p.k.

- Është plotësuar dhe dorëzuar në mënyrë të rregullt Shtojca nr. 1 "Formulari i ofertës";
- Formulari i Sigurimit të Ofertës është plotësuar dhe dorëzuar në mënyrë të rregullt sipas shtojcës nr. 3. Oferta është siguruar tek Kompania e Sigurimeve "Sigal uniuqa group" me nr. Serial 0135916 date 12.06.2017 me vlerë 2,564,967 Euro (= 2% e Investimit).
- Shtojca nr. 5 "Deklarate mbi përmbushjen e kërkesave të Dokumentave Standarte të Koncesionit" është plotësuar dhe dorëzuar në mënyrë të rregullt.

(Handwritten signatures and marks)

- Shtojca nr. 6 "Deklarate mbi konfliktin e interesave" është plotësuar dhe dorëzuar në mënyrë të rregullt.
- Shoqëria "Integrated Energy B.V.", sh.p.k., është shoqëri e krijuar nga 3 (tre) shoqëri - ortakë:
 - a) ENERGY RECUPERATOR S.p.a.,
 - b) INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES sh.p.k. dhe
 - c) PAUL WURTH ITALIA s.p.a.

Në bazë të Akt themelimi dhe statuti i shoqërisë nga ku rezultojnë se kjo është një shoqëri e themeluar nga tre operatorët e lartpërmendur: ENERGY RECUPERATOR S.p.a.; INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES sh.p.k. dhe PAUL WURTH ITALIA s.p.a. Tre operatorët ekonomikë kanë dhënë miratimin e tyre, nëpërmjet organeve vendimmarrëse respektive, për bashkimin e kapaciteteve të tyre me shoqërinë e lidhur "Integrated Energy B.V.", për të marrë pjesë në këtë procedurë koncesioni për ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.

- Ekstrakt i biznesit të Dhomës së Tregëtisë Hollandë, i datës 16.05.2017.
- Profili i kompanisë nga Dhoma e Tregëtisë Hollandë, i datës 15.05.2017.
- Vetëdeklarim se subjekti nuk është i dënuar për ndonjë veprë penale sipas parashikimit në nenin 45/1 të LPP dhe që nuk ka ndonjë vendim të formës së prerë që e dënon për çështje lidhur me aktivitetin e tij profesional, korrupsion, mashtrim apo pastrim parash. Dokument i nënshkruar nga përfaqësuesi i ofertuesit Thomas Walter Hansmann, me datë 12.06.2017, i përkthyer.
- Vetëdeklarim për ofertuesit e huaj, sipas të cilit OE, nuk është në procedurë falimentimi apo likuidimi; nuk është i dënuar për vepra penale; nuk ka vendim të formës së prerë që e dënon lidhur me aktivitetin profesional; nuk ka asete të bllokuara nga zyra e përmbarrimit, apo ndonjë urdhër sekuestro për to; ka përmbushur detyrimet fiskale dhe ato të sigurimeve shoqërore.
- Akt themelimi dhe statuti i shoqërisë nga ku rezultojnë se kjo është një shoqëri e themeluar nga tre operatorët e lartpërmendur: ENERGY RECUPERATOR S.p.a.; INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES sh.p.k. dhe PAUL WURTH ITALIA s.p.a.
- Dokument i datës 18 Maj 2017, i cili përcjell një dokument të LOYENS LOEFF, të datës 16 Maj 2017, nga ku rezultojnë se subjekti nuk ka detyrime tatimore, TVSH, apo sigurime shoqërore të pashlyera.
- **Vendimet e Asambleve të secilit ortakë, themelues të shoqërisë "Integrated Energy B.V.", sh.p.k, si dhe të vetë shqyrtimit të pjesëmarrësve:**
 - Për ENERGY RECUPERATOR S.p.a. - Procesverbali i Asamblesë së shoqërisë i datës 12 Prill 2017, ku miratohet pjesëmarrja e shoqërisë në garën e koncesionit, me objekt "Dhënia me koncesion e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë". Asambleja ka vendosur të marrë pjesë me kompaninë INTEGRATED ENERGY B.V., ku zotëron 30% të aksioneve dhe është themelues. Asambleja jep konsensusin për vënienë në dispozicion të çdo dokumenti, kapaciteti, apo informacioni për marrjen pjesë në këtë garë.

- Për **INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES sh.p.k.** - Vendim nr.7, datë 18.05.2017, i ortakut të vetëm, me të cilin miratohet pjesëmarrja e shoqërisë në garën e konçesionit, me objekt "Dhënia me koncesion e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë". Ortaku i vetëm ka vendosur të marrë pjesë, e të konsolidojë të dhënat me kompaninë INTEGRATED ENERGY B.V.. Ortaku jep konsensusin për vënien në dispozicion të çdo dokumenti, kapaciteti apo informacioni për marrjen pjesë në këtë garë kësaj kompanie (INTEGRATED ENERGY B.V.), ku edhe zotëron aksione si themelues.
- Për **PAUL WURTH ITALIA s.p.a.** - Procesverbal i Këshillit Administrativ të shoqërisë, i datës 23 Prill 2017, ku miratohet pjesëmarrja e shoqërisë në garën e konçesionit, me objekt "Dhënia me koncesion e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë". Këshilli ka vendosur të marrë pjesë me kompaninë INTEGRATED ENERGY B.V., ku zotëron aksione dhe është themelues. Këshilli jep konsensusin për vënien në dispozicion të çdo dokumenti, kapaciteti apo informacioni për marrjen pjesë në këtë garë.
- Për "**Integrated Energy B.V.**" - Vendimi i bordit drejtues, i datës 15 Maj 2017, ku miratohet pjesëmarrja e shoqërisë në garën e konçesionit, me objekt "Dhënia me koncesion e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë". Bordi drejtues vetëdeklaroi se nuk ka asnjë pengesë ligjore dhe organizative për pjesëmarrjen në këtë garë.
- Deklaratë për kursin e këmbimit të ofertës, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë

Shoqëria "ENERGY RECUPERATOR" S.p.a.

1. Ekstrakt i thjeshtë i subjektit, lëshuar nga Dhoma e tregëtisë dhe Industrisë, Zejtarisë dhe Bujqësisë në Breshia, me numër protokoll CEW/1030/2017/CBS0401, me datë 04/05/2017, i përkthyer.
2. Ekstrakt historik i subjektit, lëshuar nga Dhoma e tregëtisë dhe Industrisë, Zejtarisë dhe Bujqësisë në Breshia, me numër protokoll CEW/1031/2017/CBS0401, me datë 04/05/2017, i përkthyer.
3. Statuti i ndryshuar i shoqërisë, i datës 23.12.2013, para noterit Fabrizio Rossi.
4. Akti i transformimit të shoqërisë, i vitit 1991, ku evidentohet ndërrimi i emrit të shoqërisë nga "BUOVA RECUPERATOR S.A.S DI IVO VERONA E C" në ENERGY RECUPERATOR S.p.a.
5. Vetëdeklarim se subjekti nuk është i dënuar për ndonjë veprë penale sipas parashikimit në nenin 45/1 të LPP dhe që nuk ka ndonjë vendim të formës së prerë që e dënon për çështje lidhur me aktivitetin e tij profesional, korrupsion, mashtrim apo pastrim parash. Dokument i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor Ernesto Granelli me datë 12.06.2017.
6. Vetëdeklarim për ofertuesit e huaj (shtojca 12), sipas të cilit OE, nuk është në procedurë falimentimi apo likuidimi; nuk është i dënuar për vepra penale; nuk ka vendim të formës së prerë që e dënon lidhur me aktivitetin profesional; nuk ka asete të bllokuara nga zyra e përmbarimit, apo ndonjë urdhër sekuestro për to; ka përmbushur detyrimet fiskale dhe ato të sigurimeve shoqërore.

7. Dokument i lëshuar nga Agjencia e Taksave, Drejtoria Rajonale e Genovas, Zyra Vendore e Genovas 2, që provon se subjekti nuk ka detyrime të pashlyera deri më datë 25 Maj 2017.
8. Një vetëdeklarim, i datës 09.06.2017, i shoqëruar nga konfirmimi online i pagesës së detyrimeve për sigurimet shoqërore DURC, nga i cili rezulton se nuk ka detyrime.
9. Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, lëshuar nga ENERGY RECUPERATOR S.p.a., me datë 09.06.2017, që provon shlyerjen e detyrimeve në vendin e origjinës, Itali. Dokumenti është i përkthyer. Detyrimi ligjor është në fakt i lidhur me shtetin shqiptar, dhe nuk aplikohet për ofertuesit e huaj sipas DST dhe legjislacionit në fuqi.

Shoqëria "INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES" sh.p.k.

1. Ekstrakt të thjeshtë të regjistrimit të subjektit nga QKB.
2. Ekstrakt historik të subjektit nga QKB.
3. Statuti dhe akt themelimi i sh.p.k. INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES.
4. Deklaratë për gjendjen gjyqësore të subjektit e datës 12.06.2017.
5. Vërtetim i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të medhenj, me nr.prot. 9247 dhe datë 02.05.2017, sipas të cilit, deri në këtë datë, subjekti nuk ka detyrime të pashlyera për detyrimet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore e shëndetsore.
6. Vërtetim i lëshuar nga OSHE, me nr.prot 5487, datë 05.06.2017, që vërteton se subjekti nuk ka detyrime të pashlyera.

Shoqëria "PAUL WURTH ITALIA" s.p.a.

1. Ekstrakt i thjeshtë i subjektit, lëshuar nga Dhoma e tregëtisë dhe Industrisë, në Genova, me numër protokoll CEW/879/2017/CGE0224, me datë 15/05/2017, i përkthyer.
2. Ekstrakt historik i subjektit, lëshuar nga Dhoma e tregëtisë dhe Industrisë, në Genova, me numër protokoll CEW/880/2017/ CGE0224, me datë 15/05/2017, i përkthyer.
3. Akt themelimi i shoqërisë, i datës 19.04.2005, para noterit Francesco Cavallone.
4. Vetëdeklarim se subjekti nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale sipas parashikimit në nenin 45/1 të LPP dhe që nuk ka ndonjë vendim të formës së prerë që e dënon për çështje lidhur me aktivitetin e tij profesional, korrupsion, mashtrim apo pastrim parash. Dokument i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor Thomas Ealter Hansmann, me datë 12.06.2017.
5. Vetëdeklarim për ofertuesit e huaj, sipas të cilit OE, nuk është në procedurë falimentimi apo likuidimi; nuk është i dënuar për vepra penale; nuk ka vendim të formës së prerë që e denon lidhur me aktivitetin profesional; nuk ka asete të bllokuara nga zyra e përmbarimit, apo ndonjë urdhër sekuestro për to; ka përmbushur detyrimet fiskale dhe ato të sigurimeve shoqërore.
6. Dokument i lëshuar nga Agjencia e Taksave, Drejtoria Rajonale e Genovas, Zyra Vendore e Genovas 2, që provon se subjekti nuk ka detyrime të pashlyera deri më datë 08 Maj 2017.

7. Një vetëdeklarim, i datës 09.06.2017, i shoqëruar nga konfirmimi online i pagesës së detyrimeve për sigurimet shoqërore DURC, nga i cili rezulton se nuk ka detyrime.
8. Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, lëshuar nga PAUL WURTH ITALIA s.p.a., me datë 09.06.2017, që provon shlyerjen e detyrimeve në vendin e origjinës, Itali. Dokumenti është i përkthyer. Detyrimi ligjor është në fakt i lidhur me shtetin shqiptar, dhe nuk aplikohet për ofertuesit e huaj sipas DST dhe legjislacionit në fuqi.

Dokumentacioni i mësipërm, përmbush kushtin për afatin 3 mujor të lëshimit të informacionit. Dokumentacioni i paraqitur nga 3 operatorët e huaj është i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar konform ligjit.

Konkluzion:

Për sa më lartë, rezulton se ofertuesi, Shoqëria "Integrated Energy B.V.", i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta ligjore të përcaktuar në shtojcën nr. 9 te DSK. dhe si rrjedhojë kualifikohet për fazat e mëtejshme.

Relacion mbi përmbushjen e Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar

Shoqëria "ENERGY RECUPERATOR" S.p.a.

- Deklaratë për paraqitjen e bilanceve e datës 09.06.2017 dhe xhirot vjetore përkatësisht për vitet 2014-2015-2016 shoqëruar edhe me kopjet respektive të bilanceve:
 - v. 2014 – 3,523,813 Euro
 - v. 2015 – 8,203,261 Euro
 - v. 2016 – 7,137,839 Euro
- Kopje të bilancit të vitit 2016, shoqëruar edhe me një vetëdeklarim, ku sqarohen afatet e miratimit të bilancit nga asambleja e shoqërisë, sipas legjislacionit Italian.

Shoqëria "INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES" sh.p.k.

- Kopje të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve, të bilanceve të shoqërisë, për vitet 2014, 2015 dhe 2016.
- Vërtetim i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të medhenj, me nr.prot. 7448 dhe datë 04.04.2017, për xhiron vjetore të shoqërisë:
 - v. 2014 – 162,018,802 Leke
 - v. 2015 – 364,865,718 Leke
 - v. 2016 – 1,310,168,613 Leke

Shoqëria "PAUL WURTH ITALIA" s.p.a.

- Deklaratë për paraqitjen e bilanceve e datës 09.06.2017 dhe xhirot vjetore përkatësisht për vitet 2014-2015-2016 shoqëruar edhe me kopjet respektive të bilanceve:
 - v. 2014 – 116,091,565 Euro
 - v. 2015 – 96,192,382 Euro
 - v. 2016 – 104,596,480 Euro

- Kopje të bilancit të vitit 2016, shoqëruar edhe me një vetëdeklarim, ku sqarohen afatet e miratimit të bilancit nga asambleja e shoqërisë, sipas legjislacionit Italian.
- Vërtetim bankar, i lëshuar në Milano në 5 Qershor 2017, nga banka BNL, ku konfirmohet se OE, gjatë vitit 2016, ka depozituar shumën 15,000,000 Euro.

Investimi - 128,248,330 Euro, 2-fishi – 256,496,660 Euro

Vlerësimi

Per sa me sipër, konstatohet se gjithsej:

- ✓ Xhiro Kumulative e v. 2014, v. 2015 dhe v. 2016 jane 335,745,340 Euro (> se 2 –fishi i Investimit - 256,496,660 Euro) dhe 1,837,053,133 Leke
- ✓ Vërtetim Bankar ne emer te Shoqërise “Paul Wurth Italia” s.p.a. – 15,000,000 Euro

Konkluzion:

Për sa më lartë, rezulton se ofertuesi, Shoqëria "Integrated Energy B.V." plotëson kriterin financiar kualifikues dhe si rrjedhojë kualifikohet për fazat e mëtejshme.

Relacion mbi përmbushjen e Kapacitetit Teknik dhe Profesional

Punime te ngjashme

Shoqëria “ENERGY RECUPERATOR” S.p.a.

- Akt vlerësimi për punë të ngjashme me investitor YKK Italia. Kohëzgjatja e kontratës Janar – Mars 2013. Vlera e kontratës 110,000 Euro. Shoqëruar me akt – kolaudimi i datës 17 Maj 2013, kopje kontrate dhe shtesë kontrate, dhe faturat. Me objekt furnizim dhe vendosje kaldaje.
- Akt vlerësimi për punë të ngjashme me investitor S.I.P.E.A. srl. Italia. Kohëzgjatja e kontratës Shkurt 2012 – Mars 2013. Vlera e kontratës 12,800,000 Euro. Shoqëruar me akt – kolaudimi i datës 8 Maj 2013, kopje kontrate (nënshkruar në vitin 2006) dhe kopje faturash. Me objekt Realizimi i një centrali elektrik me bashkëgjenerim me biomasë, me fuqi të barabartë me 5.1 Mwe, për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike të vendosur në Rivarolo Canavese.
- Akt vlerësimi për punë të ngjashme me investitor T.S.N. srl. Italia. Kohëzgjatja e kontratës Korrik 2012 – Maj 2013. Vlera e kontratës 3,030,000 Euro. Shoqëruar me akt – kolaudimi i datës 6 Maj 2013, kopje kontrate dhe kopje faturash. Me objekt Realizimi i një centrali elektrik me bashkëgjenerim me biomasë, me fuqi të barabartë me 3 Mwe, për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike të vendosur në Sellero..

Shoqëria “INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES” sh.p.k.

- Akt vlerësimi për punë të ngjashme me investitor Albtek Energy sh.p.k.. Kohëzgjatja e kontratës nënshkruar në 20.02.2015 – 30.12.2016. Vlera e kontratës 3,000,000 Euro pa TVSH. Shoqëruar me akt kolaudimi 10.01.2017, akt marrje në dorëzim i datës

17.01.2017, kopje kontrate dhe shtesë kontrate, dhe faturat. Me objekt punime civile si gërmime, betonarme, sistemim argjinature, pastrim, mirëmbajtje të dampes dhe bregut pranë lumit Shkumbin, etj. në funksion të ndërtimit të landfillit të Elbasanit, menaxhimi i landfillit dhe transportimi i brendshëm i mbetjeve. Ka edhe një amendim kontrate 2, nëpërmjet të cilës i shtohet volumi i punëve civile, por pa një vlerë të caktuar. Nga situacionet e paraqitura, rezulton se deri në Nëntor 2016, pagesa totale është 7.480.474 Euro.

- Akt vlerësimi për punë të ngjashme me investitor Ministria e Mjedisit. Kohëzgjatja e kontratës nënshkruar në 30.05.2016 – 18.07.2016. Vlera e kontratës 101,240,160 lekë (pa TVSH). Shoqëruar me akt kolaudimi 19.08.2016, akt marrje në dorëzim i datës 01.09.2016, kopje kontrate dhe faturat. Me objekt ndërtimi i impiantit të pastrimit të grykëderdhjes së lumit Shkumbin dhe rikualifikimi i vijës bregdetare Vilë Boshtovë Rrogozhinë. Në këtë kontratë operatori është paraqitur si bashkim operatorësh ekonomikë dhe ka qenë pjesëmarrës me 65% të kontratës.

Shoqëria "PAUL WURTH ITALIA" s.p.a.

- Kontratë për punime të ngjashme, me objekt Ndërtim impiant furre koksi dhe impiant trajtimi gazi me mulli çeliku të integruar, ndërmjet PT.KRAKATAU POSCO DHE KONSORCIUMIT: PAUL WURTH ITALIA s.p.a., POSCO Engineering&Construction Co., Ltd, PT.KRAKATAU ENGINEERING dhe PT POSCO E&C INDONESIA. Kontrata ka hyrë në fuqi më 17 Mars 2011. Vlera e kontratës është 63,800,000 Euro. Kjo vlerë me amendimin 1 ka ndryshuar në 63,331,080 Euro. Me amendimin 2 vlera e kontratës është 54,960,000 Euro. Me amendimin 3 vlera e kontratës është 136,645,600 USD. Kontrata shoqërohet me faturat, me situatën e faturimit, çertifikata finale të pranimit dhe protokollet e pranimit, që variojnë në datat 12 Shkurt 2014- 12 Dhjetor 2014, të cilat provojnë se kontrata është realizuar sipas kërkesave të porositësit. Konkluzionet përfundimtare të projektit, në datë 30 Mars 2015, sipas të cilit projekti është realizuar me sukses.
- Kontratë me ILVA s.p.a., me objekt Ndërtim dhe modernizim i furnaltës "AFO/1", me vlerë 5.594.103,5 Euro, e datës 01.10.2013, me afat përfundimi 31 Korrik 2015 Shoqëruar me fatura dhe situacione periodike. Vërtetim i lëshuar nga ILVA s.p.a., për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, për efekt pajisje me licencë, që provon se OE, ka realizuar këtë kontratë në periudhën 2013-2015. Procesverbal për përfundimin e punimeve i datës 30.09.2015.
- Kontratë me ILVA s.p.a., me objekt Impianti i depurimit "GAS-AFO" për furnaltën "AFO/1", me vlerë 9,130,000 Euro, e datës 04.12.2013, me afat përfundimi 31 Korrik 2015. Shoqëruar me fatura dhe situacione periodike. Vërtetim i lëshuar nga ILVA s.p.a., për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, për efekt pajisje me licencë, që provon se OE, ka realizuar këtë kontratë në periudhën 2013-2015. Procesverbal për përfundimin e punimeve i datës 30.09.2015.

Shenim: Për pikën 1/e, është paraqitur Deklarimi për informacionin konfidencial, sipas të cilit i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga OE është konfidencial për katër operatorët:

ENERGY RECUPERATOR S.p.a., INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES sh.p.k.,
PAUL WURTH ITALIA s.p.a., INTEGRATED ENERGY B.V..

Licencat dhe Certifikata ISO

Shoqëria "ENERGY RECUPERATOR" S.p.a.

- Çertifikatë ISO – 9001:2008, e vlefshme deri më 14.09.2018.

Shoqëria "INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES" sh.p.k.

- Licencë të shoqërisë, me nr. NZ.6917/5, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, me këto pika:

- NP- 1/E
- NP- 2/A
- NP- 3/A
- NP- 4/A
- NP- 5/A
- NP- 6/A
- NP- 7/A
- NP- 9/C
- NP- 11/B
- NP- 12/B
- NS – 1/A
- NS – 2/F
- NS – 3/A
- NS – 4/A
- NS – 5/A
- NS – 6/A
- NS – 7/A
- NS – 9/A
- NS – 10/A
- NS – 11/A
- NS – 12/A
- NS – 14/C
- NS – 15/B
- NS – 16/A
- NS – 17/E
- NS – 18/B
- NS – 20/A

Kjo licencë është pa afat kohor.

- Çertifikatë ISO – 9001:2008, e vlefshme deri më 15.09.2018.
- Çertifikatë EN ISO – 14001:2004, e vlefshme deri më 15.09.2018.

- Çertifikatë OHSAS – 18001:2007, e vlefshme deri më 26.04.2019.
- Çertifikatë ISO –39001:2012, e vlefshme deri më 19.03.2020.
- Çertifikatë PAS – 99:2012, e vlefshme deri më 19.03.2018.
- Çertifikatë EN ISO – 50001:2011, e vlefshme deri më 19.03.2020.
- Çertifikatë ISO/IEC – 27001:2013, e vlefshme deri më 19.03.2020.
- Licencë nga QKB, kategoria për Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, për veprimtarinë e transportit të mjetëve urbane. Licencë nga Ministria e Mjedisit për transportimin e mjetëve urbane.

Shoqëria “PAUL WURTH ITALIA” s.p.a.

- Çertifikatë ISO 9001-2008, me afat deri 24.06.2018.

Gjithashtu jane paraqitur:

Shoqëria “INTEGRATED ENERGY B.V”

- Organigrama, plani i administrimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes, për koncesionin e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.
- Shoqëruar me CV për të provuar kapacitetin profesional si vijon:

Shoqëria “ENERGY RECUPERATOR” S.p.a.

- CV Ernesto Granelli – pozicioni drejtor i përgjithshëm i shoqërisë. I diplomuar në inxhinjeri mekanike. Me eksperiencë pune 47 vjet.
- CV Sergio Gentilini – pozicioni projektues në shoqëri. I diplomuar në inxhinjeri mekanike. Me eksperiencë pune 18 vjet.
- CV Filippo Perbellini – pozicioni drejtim inxhinjerie në shoqëri. I diplomuar në inxhinjeri mekanike. Me eksperiencë pune 16 vjet.
- CV Toni Sergio – pozicioni projektim ndërtim kaldajash, impiante, etj. në shoqëri. I diplomuar si gjeometër. Me eksperiencë pune 32 vjet.

Shoqëria “INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES” sh.p.k.

- CV Gentian Dume – pozicioni Pedagog në Universitetin Politeknik të Tiranës. I diplomuar në inxhinjeri elektrike. Me eksperiencë pune 11 vjet. (Nuk ka lidhje me OE).
- CV Julia (Muça) Demneri – pozicioni ekonomiste në shoqëri. E diplomuar në financë-kontabilitet. Me eksperiencë pune 8 vjet.
- CV Helada Papa – pozicioni juriste në shoqëri. E diplomuar në drejtësi. Me eksperiencë pune 2 vjet.
- CV Edvina Mihasi – pozicioni pedagoge në Universitetin e Tiranës. E diplomuar në inxhinjeri mjedisi. Me eksperiencë pune 6 vjet. (Nuk ka lidhje me OE).
- CV Leka Kosta – pozicioni drejtues teknik, inxhinjer ndërtimi i shoqërisë. I diplomuar në inxhinjeri ndërtimi. Me eksperiencë pune 46 vjet.

- CV Erion Zharku – I diplomuar në inxhinjeri civile-gjeodezi. Me eksperiencë pune 12 vjet.

Shoqëria "PAUL WURTH ITALIA" s.p.a.

- CV Stefano Magnani – pozicioni inxhinjer procesimi dhe projekti. I diplomuar në inxhinjeri civile dhe mjedisore dhe në inxhinjerinë e ujit dhe ruajtjes së tokës. Me eksperiencë pune 6 vjet.
- CV Corrado Ferrari – pozicioni drejtor i shitjeve për teknologjitë mjedisore. I diplomuar në inxhinjeri mekanike. Me eksperiencë pune 22 vjet.
- CV Fabio Fabiola – pozicioni zëvendëspresident i shoqërisë. I diplomuar në inxhinjeri mekanike. Me eksperiencë pune 36 vjet.
- CV Stefano Barozzi – pozicioni zëvendëspresident i shoqërisë. I diplomuar në inxhinjeri kimike. Me eksperiencë pune 36 vjet..

Konkluzion:

Për sa më lartë, rezulton se ofertuesi, Shoqëria "INTEGRATED ENERGY B.V" i plotëson kërkesat teknike për kualifikim e si rrjedhojë, kualifikohet për fazat e mëtejshme.

Me pas Komisioni vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e studimit të fizibilitetit të paraqitur nga ku konstatoi se janë paraqitur si me poshte vijon:

- Studimi i fizibilitetit për projektin e koncesionit të ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.
- Plan Biznesi, i datës Maj 2017, për objektin e koncesionit "ndërtimi i landfillit, inceneratorit dhe i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë"
- Vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe në faktorët socialë për projektin e koncesionit të ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.
- Kontratë ndërmjet Integrated Energy B.V. dhe ARKADIS ITALIA L.T.D., për hartimin nga ky i fundit të studimit të fizibilitetit dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe faktorët social. Shoqëruar me ekstraktin e regjistrit tregëtar për subjektin ARKADIS ITALIA L.T.D., nga ku provohet se operatori ka të gjitha kapacitetet teknike dhe ligjore për hartimin e këtyre studimeve.
- Kontratë ndërmjet Integrated Energy B.V. dhe ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS sh.p.k., shoqëri shqiptare, për hartimin e studimit të vlerësimin të ndikimit në mjedis dhe faktorët social për projektin e koncesionit të ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë. Shoqëruar me ekstraktin e regjistrit tregëtar për subjektin nga QKB, licencën nga QKB, licencën dhe

çertifikatat nga Ministria e Mjedisit, nga ku provohet se operatori ka të gjitha kapacitetet teknike dhe ligjore për hartimin e këtyre studimeve.

- Grafiku i punimeve.
- Studimi për skemën elektrike në 5 variante, shoqëruar edhe me relacionin teknik për çdonjërin prej tyre.
- Oponenca teknike për projektin e koncesionit të ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë, hartuar nga d&c partners. Në përfundim të analizës që bën openentë, arrin në konkluzionin se projekti i koncesionit të ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë, i plotëson të gjitha kërkesat e standarteve Evropiane, për sa i përket mënyrës së zgjidhjes, qëndrueshmërisë konstruktive, mbrojtjes së mjedisit dhe të gjithë elementët e tjerë që kanë të bëjnë me funksionimin normal të landfillit.
- Planrilevimi topografik i zonës.
- Projekti i rruges që lidh objektin me rrugën nacionale.
- Projekti i rrugës së aksesit në objekt.
- Raporti teknik për projektin e koncesionit të ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.
- Kontratë ndërmjet Integrated Energy B.V. dhe personit fizik Bujar Karanxha, për realizimin e projektit rrugor dhe topografinë e zonës. Dokumenti shoqërohet me licencën e subjektit dhe ekstraktin historik të personit fizik, që provon se ka kapacitetin profesional dhe ligjor për realizimin e kontratës ndërmjet palëve.
- Raport mbi kushtet gjeologo-inxhinjerieke dhe studim inxhiniero-sizmologjik të sheshit të ndërtimit të projektit dhënia me koncesion e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë. (Hartuar nga ALTEA geostudio 2000).
- Kontratë ndërmjet Integrated Energy B.V. dhe ALTEA geostudio 2000, ku kjo e fundit merr përsipër të hartojë Raportin mbi kushtet gjeologo-inxhinjerieke dhe Studimin inxhiniero-sizmologjik të sheshit të ndërtimit të projektit dhënia me koncesion e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë. Dokumenti shoqërohet me licencën e subjektit dhe ekstraktin historik të subjektit nga QKB, që provon se ka kapacitetin profesional dhe ligjor për realizimin e kontratës ndërmjet palëve.
- Analiza e sheshit: pozicioni gjeografik, lidhja me infrastrukturën rrugore dhe qendrën, analiza klimaterike, plani i vendosjes aktuale, prerje të terrenit, pamje të gjendjes ekzistuese.
- Fazat e punimeve: pamje tredimensionale informuese e sheshit, planvendosja e objekteve pas përfundimit të punimeve, plani i zonimit funksional (faza I), plani i zonimit funksional (faza II), plani i zonimit funksional (faza III), plani i zonimit funksional (faza IV), plani i zonimit funksional (faza V), plani i zonimit funksional (faza VI), plani i zonimit funksional (faza VII).
- Imazhe tredimensionale të sheshit.
- Projekti arkitektonik i veprës shoqëruar me relacionin shpjegues.

- Projekti elektrik i veprës shoqëruar me relacionin shpjegues.
- Projekti hidroteknik i veprës shoqëruar me relacionin shpjegues.
- Projekti konstruktiv i veprës shoqëruar me relacionin shpjegues (impianti, nënstacioni).
- Projekti i landfillit: planvendosja e përgjithshme e pozicionimit të vëndepozitimeve, planimetria dhe seksionet për projektin e vëndepozitimeve të M.N.U., shtresat e vëndepozitimeve të M.N.U., planimetria e drenazhimit të ujrave të ndotur nga fundi i vëndepozitimeve të M.N.U., planimetria e kultivimit të vëndepozitimit të M.N.U., planimetria e mbylljes përfundimtare të vëndepozitimit të M.N.U., planimetria e rjetit të kapjes së biogazit, shoqëruar me relacionin shpjegues.
- Projekti i landfillit të hireve (planvendosjet respektive) shoqëruar me relacionin shpjegues.
- Projekti për depozitim të inerteve (planvendosjet respektive) shoqëruar me relacionin shpjegues.
- Projekti i planit indikativ (planvendosjet respektive për skemën e impiantit të selektimit të mbetjeve, impiantit të mbrojtjes nga zjarri, impiantit elektrik) shoqëruar me relacionin shpjegues.
- Projekti i bonifikimit të landfillit ekzistues (planvendosjet respektive) shoqëruar me relacionin shpjegues.
- Projekti i impiantit të ujrave të ndotur (planvendosjet respektive) shoqëruar me relacionin shpjegues.
- Projekti i mbrojtjes kundër zjarrit, shoqëruar me relacionin teknik përkatës.
- Relacioni i planit të emergjencës
- Projekti teknologjik (planvendosjet respektive) dhe relacionin shpjegues.
- Kontratë ndërmjet Integrated Energy B.V. dhe DE MARE L.T.D., sipas së cilës ky i fundit, ngarkohet për realizimin e projekteve teknike të landfillëve, projektin teknik për rikuperimin e vëndepozitimeve ekzistuese, projektin teknik të impiantit të ujrave të ndotur, projektin tregues/indikativ për skemën e impiantit të selektimit të mbetjeve. Shoqëruar me licencën përkatëse dhe ekstraktin e regjistrimit tregtar nga vendi i originës.
- Kontratë ndërmjet Integrated Energy B.V. dhe AVE CONSULTING, sipas së cilës ky i fundit, ngarkohet për realizimin e projektit konstruktiv të landfillëve. Shoqëruar me licencën përkatëse dhe ekstraktin e regjistrimit tregtar nga QKB.
- Kontratë ndërmjet Integrated Energy B.V. dhe ECHOSTAR sh.p.k., sipas së cilës ky i fundit, ngarkohet për realizimin e projektit hidroteknik dhe teknologjik. Shoqëruar me licencën përkatëse dhe ekstraktin e regjistrimit tregtar nga QKB.
- Kontratë ndërmjet Integrated Energy B.V. dhe ONYX sh.p.k., sipas së cilës ky i fundit, ngarkohet për realizimin e projektit elektrik të landfillëve. Shoqëruar me licencën përkatëse, ekstraktin e regjistrimit tregtar nga QKB.
- Kontratë ndërmjet Integrated Energy B.V. dhe personit fizik Pëllumb Tukseferi, sipas së cilës ky i fundit, ngarkohet për realizimin e projektit për mbrojtjen ndaj zjarrit. Shoqëruar me lejen për ushtrimin e profesionit dhe ekstraktin e regjistrimit tregtar nga QKB.
- Kontratë ndërmjet Integrated Energy B.V. dhe RM STUDIO ARCHITECTURE+PARTNERS sh.p.k., sipas së cilës ky i fundit, ngarkohet për

realizimin e projektit arkitekturale. Shoqëruar me licencën përkatëse dhe ekstraktin e regjistrit tregtar nga QKB.

- Deklaratë e Z. Ernesto Graneli, përfaqësues ligjor i shoqërisë ENERGY RECUPERATOR S.p.a, i cila ka treguar gatishmërinë e tij për projektimin e Termovalorizuesit të Tiranë në procedurën dhënia me koncesion e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.

Vleresimi:

Ofertuesi ka paraqitur të gjitha studimet, projektet, etj, në përputhje me kërkesat e Dokumentave Standarte të Koncesionit, për strukturën dhe përmbajtjen e tyre si dhe janë respektuar legjislacioni në fuqi në fushën e mjedisit dhe atë të ndërtimit (punëve civile). Projekti respekton termat e referencës të vendosura nga Autoriteti Kontraktues.

I gjithë dokumentacioni, për subjektet e huaja në këtë procedurë, është përkthyer dhe noterizuar, konform legjislacionit në fuqi.

Karakteristikat e ofertes të paraqitur nga Shoqëria "Integrated Energy B.V.", janë:

- Vlera e investimit 128,248,330 €
- Vlera e "Fee koncesionare" 2.1%
- Vlera e depozitimit të mbetjeve 29 €/ton
- Koha e ndërtimit dhe venies në shfrytëzim 6 muaj

Vleresimi me pike:

Nr	Kriteret	Pike max	Pike Oferta
1	Ndikimi mjedisor dhe ndikimi social	27	27
2	Permbushja e kriterëve teknike	26	26
3	Vlera e Investimit	16	16
4	Vlera e "Fee koncesionare"	10	10
5	Vlera e depozitimit të mbetjeve	8	8
6	Koha e ndërtimit dhe venies në shfrytëzim	5	5
	Bonusi dhene shoqërisë nepermjet V.K.M. nr. 856/2016		8
	TOTALI	100	100

Si rrjedhojë KVO e vlerëson këtë oferte me **100 pike** nga 100 pike të mundshme.

Bazuar sa më lartë, Komisioni i Dhenies së Koncesionit vendos kualifikimin si oferte të vetme me **100 pike**, shoqërine "Integrated Energy B.V." dhe në baze të Ligjit Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij

Ligji, njofton ofertuesin pjesëmarrës në këtë procedurë konkurruese për klasifikimin përfundimtar si dhe i propozon Kryetarit të Autoritetit Kontraktues, të shpallë fitues shoqëri

Komisioni i Dhënies Koncesionit

Valbona Ballgjini

Pëllumb Abeshi

Etleva Kondi

Namik Simixhiu

Taulant Tusha

Sidita Temali

Erjon Murataj